

RELACION SHPJEGUES

PËR PROJEKTVENDIMIN

“PËR

MIRATIMIN E KATALOGUT SHQIPTAR TË KLASIFIKIMIT TË MBETJEVE”

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN.

Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, në kuadër të iniciativave të vazhdueshme për harmonizimin e legjislacionit në fushën e mjedisit në përgjithësi, dhe në atë të menaxhimit të mbetjeve në veçanti, si dhe për të përshtatur bazën ligjore mbi të cilën lind nevoja e përgatitjes së këtij akti, hartoi vendimin që miraton katalogun shqiptar të klasifikimit të mbetjeve. Objektivi kryesor është përditësimi i katalogut shqiptar të mbetjeve në përputhje me katalogun evropian të mbetjeve. Katalogu i vjen në ndihmë bizneseve që grumbullojnë, transportojnë apo trajtojnë mbetjet. Ai synon të rregullojë dhe orientojë bizneset vendase që angazhohen në mbrojtjen e mjedisit përmes ripërdorimit, riciklimit dhe përpunimit të mbetjeve, kursimin e lëndëve të para natyrore të vendit, duke përdorur kodet e mbetjeve të cilat janë të unifikuara në të gjithë vendet evropiane për të identifikuar mbetjen. Mbetjet e rrezikshme dallohen nga ato jo të rrezikshme pasi në fund të kodit përmbajnë shenjën “*”. Projektvendimi hartohet në zbatim të pikës 1, të nenit 9, të ligjit nr. 10463, datë 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, të ndryshuar. Tipet e ndryshme të mbetjeve në katalog janë të përcaktuara me një kod 6-shifror, ndërsa kapitujt dhe nënndarjet përkatëse që i gjenerojnë këto mbetje, jepen përkatësisht me kode 2-shifrorë dhe 4-shifrorë. Miratimi i këtij projektvendimi do të lehtësojë dhe ndihmojë biznesin, si dhe do të ndikojë për një mirë menaxhim të qëndrueshëm të mbetjeve në vendin tonë.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTESHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR.

Ky projekt vendim është hartuar në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës si dhe propozohet në bazë të delegimit të parashikuar në pikën 1, të nenit 9, të ligjit nr. 10463, datë 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, të ndryshuar.

Projektvendimi transponon plotësisht direktivën 2014/955/EC, me Vendim Komisioni të datës 18 Dhjetor 2014. Katalogu i mbetjeve i paraqitur në këtë draft, ka disa kode mbetjesh më tepër se katalogu i mëparshëm dhe kodet e shtuara lidhen me mbetjet e mërkurit.

Për sa më sipër, akti i propozuar është jo vetëm në përputhje me bazën ligjore në fuqi por edhe me direktivën më të fundit të Bashkimit Evropian.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS COMMUNAUTAIRE (PËR PROJEKT-AKTET NORMATIVE).

Ky projektvendim synon të transpozojë plotësisht sipas tabelës së përputhshmërisë bashkëlidhur, direktivën 2014/955/EC, me Vendim Komisioni të dates 18 Dhjetor 2014, që amendon Vendimin 2000/532/EC mbi listen e mbetjeve në vijim të direktivës 2008/98/EC të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit. Fletore Zyrtare L370, 30.12.2014, fq.44-86, çka ndihmon drejtpërdrejt në procesin e përafrimit të *Aquis* dhe negociatave për anëtarësimin me BE, kapitulli 27 “Mjedisi”.


VI. PËRMbledhje shpjeguese e përmbyajtjes së projekt-aktit.

Katalogu i mbetjeve ka në përmbyajtje pesë shtojca, të cilat janë në përputhje me përditësimet që ka pësuar Katalogu Evropian i Mbetjeve. Konkretisht:

- a) Shtojca I: Klasifikimi i mbetjeve, sipas të cilit klasifikohen llojet e mbetjeve si të rrezikshme dhe që indentifikohen me shenjë (*);
- b) Shtojca II: Vetitë dhe karakteristikat e mbetjeve të rrezikshme;
- c) Shtojca III: Kategoritë e mbetjeve të gjeneruara, të listuara sipas

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE.

Ky projektvendim nuk do të ketë efekte financiare shtesë në buxhetin e shtetit, pasi zbatimi i tij është përlogaritur në buxhetin e ligjit kuadër të mbetjeve.


MINISTËR
BLENDI KLOSI

